KUSH I VRAU LUFTËTARËT E UÇK'së PAS LUFTËS?!

Fatmir Brajshori

▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼

Me këtë Temë isha marrë shumë kohë më parë dhe kisha sjellë opinionin tim për të cilin mendoj që s'do mend nuk është më i qëlluari dhe më i vërtetuari por i cili megjithatë të detyron të mendohesh disa herë... Gjithnjë më është dukur shumë e mistershme, vrasja e disa personaliteteve të LDK-ës, pas lufte e të cilët para lufte, ishin personalitete të Partisë që e udhëhiqte Ibrahim Rugova, ndërsa para se të formohej kjo Parti ishin po ashtu personalitete të Lidhjes Komuniste të Kosovës gjegjësisht propaganduesit më të zëshëm të titizmit...

Po ashtu që 16 vite dëgjoni, lexoni, frymëzoheni nga qarqe të caktuara, me qëllim, të cilët tanë kohën trumbetojnë dhe të kërkojnë që të zbardhen vrasjet e këtyre „personaliteteve të LDK-LKK" si Enver Maloku, Ahmet Krasniqi, Tahir Zemaj, Xhemajl Mustafa etj etj..

E para, këta për asgjë si mban mend Kosova që ia bënë ndonjë të mirë! Për asgjë!
Teksa Ahmet Krasniqin dhe Tahir Zemën i mban mendë për të këqijat që ia kanë sjellë Kosovës, jo vetëm me luftën e fundit por edhe më herët…
Ajo që më shtyri sërish të sjellë edhe një herë këtë tematik ishte një shkrim i GANI GECIT i cili, që ca kohë çirret pandërprerë dhe kërthet sa mundet me kërkesën se „kush i vrau?" dhe na i sjell një dyzinë emrash të veprimtarëve të LDK-ës e të cilët para LDK-ës (80%) prej tyre ishin besnik të titizmit dhe të shtetit Jugosllavë...
Por është interesant që, LDK dhe pjestarët e kësaj partie as edhe një herë nuk kërkuan që të zbardhen vrasjet e Ushtarëve të UÇK-ës, pjesëtarëve të TMK-ës menjëherë pas lufte…
A thua pse, LDK-ja vepronte dhe vepron serish me të njëjtin avaz: Përmend vrasjen e disa veprimtarëve të saj (ajo vetëm përmend por gjithnjë ka penguar hetimet sepse mendja më thotë që pikërisht LDK-ë qëndron prapa atyre vrasjeve) por as edhe një herë vrasjet e luftëtarëve të lirisë?
Do mundohemi të sjellim në vazhdim ca nga ata Luftetar lirie që u vranë pas lufte…
A ishin Klanet e mëdha brenda LDK-ës, të lidhur me Klanin e Zemunit?
Strukturat dhe klanet e mëdha që i krijoi kupola e shërbimit serbë dhe pushteti i Millosheviqit, gjatë regjimit të tij, jo vetëm në Serbi, por edhe në rajon e në veçanti në Kosovë, paraqesin një strukturë të përsosur të pashpërbërë edhe sot e kësaj dite. Të ashtuqujturat "Polici Lokale" të formuara në kohën e regjimit të Millosheviqit, pas luftes, nuk janë marrë në pyetje për veprimtarinë e tyre dhe detyrat. Këto struktura kriminale edhe pas ndonjë goditje, kohë pas kohe janë rikonsoliduar, sidomos pas rënjes së Millosheviqit nga pushteti dhe vrasjes së Arkanit dhe disa kapove të kësaj mafie, e cila, ka një shtrirje edhe në Kosovë.
Mafia proserbe në Kosovë, duket se ka një ndikim të fuqishëm. Janë persona të përgatitur dhe të infiltruar nëpërmjet kanaleve shtetërore të aparatit të punëve të brendshme, të cilat, në të shumtën e rasteve, kanë ndërrmarrë edhe veprime politike, qoftë në urdhërdhënien për vrasje, qoftë në drejtimin e ekonomisë, biznesit, kontrabandës etj..

Sipas burimeve mirë të informuara, pjestarët e kësaj strukture që janë në veprim në Kosovë, disa herë kanë kryer trajnime të ndryshme në Batajnicë (shqiptarë) dhe kanë përvojë të gjatë në strukturat e krimit të organizuar, krimit ekonomik dhe atij politik, sidomos prej tyre që mund të numërohen në gishtërinjë këtu te ne.

Krimi politik dhe ekonomik në Kosovë shfaqen në formë të krimit të Organizuar dhe të krimeve ordinere. Veprimtaritë kriminale të organizuara në formë të krimit të organizuar dhe të krimeve ordinere zhvillohen falë rrethanave në të cilat gjendet Kosova me status të pazgjidhur, ku kanë terren të përshtatshëm të zhvillimit dhe veprimit të tyre, duke qenë burim permanent për destabilizimin e gjendjes së sigurisë.

Motivimi kryesor i veprimeve të lartëpërmendura kriminale bazohet në aktivitetet e motivuara në arsyetimin politik, në veprimtaritë e motivuara nga shërbimet sekrete të vendeve të cilat kanë qëllim armiqësor ndaj kosovës, dhe në veprimtaritë e motivuara me arsyetim të përfitimit material.

VRASJET ENIGMATIKE TE PJESËTAREVE TË UÇK'ës PAS LUFTE?

Vrasjet enigmatike të ish-pjesetarëve të UÇK-ës dhe të personaliteteve politike të Kosovës dhe veprimet që i kanë përcjellë ato, të cilat kohë pas kohe skajshmerisht e kanë rrezikuar

gjendjen e sigurisë, kanë pasqyruar shumë në destabilitetin politik dhe prishjen e imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare.
Është potencuar shumë herë nga ana e serbëve, se shërbimet serbe i kanë prej 25000 deri 50 000 bashkëpunëtorë në Kosovë, gjë që tregon për praninë e lartë të agjenturave serbe në Kosovë, që paraqesin rrezik dhe janë mjaftë shqetësuese për Kosovën dhe banorët e saj.
Së pari po të shikohet gjeografia ku ndodhin më së shumti aktet e vrasjeve ajo i prket territorit që nuk është i banuar me serbë (Rrafshi i Dukagjinit)
Supozohet se në Pejë ish komandanti ndërkombëtar i policisë së UNMIKU-t, për rajonin e Dukagjinit, Valerij Corotekno, ka qenë njëri prej koordinatorëve dhe mbështetësve të "Klanit të Zemunit", të cilët operonin në Kosovë, nëpërmjet kolegëve të tyre shqipfolës, i cili pos që ka përfituar miliona, ka ndikuar në krijimin e një gjendje kaotike, një gjendje identike të këtyre klaneve sikur të ishin në Beograd.
Disa prej tyre thuajse ishin legalizuar, kuptohet edhe me ndihmen e një grupi të vogël të personelit vendor, të cilët kanë emra dhe mbiemra dhe janë njohës të mirë të situatave dhe të ngjarjeve të ndodhura. Ka prej tyre që janë edhe bartës të atyre ngjarjeve.
Fatkeqësisht individë të këtyre strukturave e kishin edhe mbështetjen e haptë PARTIAKE, me të cilën i mbulonin dhe i kamuflonin veprimet kriminale-mafioze, të drejtuara edhe kundër vendit dhe progresit të Kosovës. Në atë periudhë ngjarjet e tilla shikoheshin ndryshe, por sot kur ka kaluar një kohë edhe kanë ndryshuar shumë gjëra, edhe këto ngjarje shikohen nga një vështrim krejtë tjetër, e vërteta ka një dimension tjetër. Dihen aktorët, dihen qëllimet, dihen viktimat, dihen disa nga vrasësit, natyrisht dihen edhe "bosët" porositës...

SHUMË NGJARJE HESHTËN PËR SHKAK TË POLITIKËS

Shumë prej vrasjeve të pas luftës kanë mbetur në heshtje dhe ndoshta do t'i mbulojë harresa, sepse në disa sish kishte dorë Politika dhe klanet politike të cilat kishin qëllimet e veta...
Viktimë e këtyre zhvillimeve është Tahir Zemaj me të birin Enisin dhe kusheririn e tij Hasan Zemaj, të vrarë më katër janar 2003. Hasani ishte Aktivist i hershëm i Forumit Rinor të LDK-ës, pjesmarrës edhe në aktivitetet tjera politiko-shoqërore, për të

cilat askush nuk mund të thotë asnjë fjalë të keqe. Ndërkaq, Tahir Zemaj, në procesin e ashtuqujtur kundër Grupit të "Dukagjinit", nuk kishte dëshmuar kundër Daut Haradinajt, dhe sipas të gjitha rrethanave, nuk mund të thuhet se është viktimë e këtyre proceseve, siç është folur në fillim.
Çuditërisht, po në ditën, e vrasjes, nga një grupacion, i paraqitur publikisht për herë të parë, me këtë rastë u lëshua një komunikatë për media. Ndërsa, ditën e varrimit të Tahirit, Enisit dhe Hasanit, në Strellc ishte promovuar "një ushtri", e cila në atë varrim, shpalosi programin e vet, për t'u hakmarrë kundër ish - strukturave të UÇK-ës, në të cilat aludonin (i akuzonin) se e kishin kryer këtë vrasje, edhe pse këta të fundit nuk kishin shkas për ta bërë këtë vrasje të trefishtë.

PRANIA PUBLIKE E FORMACIONIT PARAMILITAR

Formacioni që u promovua ditën e varrimit në Strellc të Deçanit, më vonë mori përsipër disa operacione dhe vazhdimisht nëpërmjet komunikatave kërcënonte strukturat udhëheqëse të ish-UÇK'ës, udhëheqës Politik të partive, të cilat ata i konsideronin se kanë devijuar etj etj..
Ditën e varrimit përgjegjësi i Tyre mbajti një fjalim ndërsa "ushtarët e ushtrisë së Re" ishin të veshur me të kaltra, që në fakt ishte shenjë e uniformave që kishte pasur FARK-u (grup ushtarako - Politik) i formuar dhe financuar nga Qeveria e Kosovës në egzil, i përbërë nga ish-oficerë të ish-Armatës Jugosllave. Konsiderohej forcë revanshuese e UÇK-ës, që në skenën e gjerë politike akuzonin njëri - tjetrin.
Edhe ashtu formacioni i Ri paramilitar, konsiderohej forcë e armatosur e Partisë më të madhe të LDK-ës, nëpërmjet së cilës tentohej të dominohej mbi strukturat e ish UÇK-ës.
Çuditërisht, e njëjta ngjyrë e këtij Formacioni PARAMILITAR karakterizon edhe ngjyrat e LDK-ës dhe të vet Flamurit të propozuar nga Rugova...
Për vrasjen e Sebahate Tolajt dhe Jusuf Haklajt, që nga ajo kohë janë shkruar mijëra faqe gazetash, aty - këtu janë dhënë edhe prova dhe fakte për ekzistimin dhe veprimin e këtij formacioni paramilitar, në emër të të cilit u shkruan dhjetëra afishe e komunikata.

Mirëpo, as vrasja e Tahir Zemës, Enis dhe Hasan Zemajt, deri tash nuk u zbulua sikurse që nuk u zbardh kurrë as puna e "ushtrisë" (formacionit paramilitar) që doli publikisht ditën e varrimit në Strellc dhe me rastin e homazheve në Prishtinë (për Ibrahim Rugovën) e që vazhdon të operojë edhe sot e kësaj dite, siç deklarohen vetë pjestarët e këtij formacioni.
Ngjarjet do të shkojnë aq largë, sa që thuhet se dy pjestarët e SHPK-ës, SEBAHATE TOLAJ dhe JUSUF HAKLAJ, ish-pjestarë të UÇK'ës, zyrtarë të hetimeve, pasi kishin zbuluar dhe kompletuar dosjen, për vrasjen e trefishtë të Tahir Zemajt me të birin dhe kushëririn, të dy vriten në një prit të organizuar në afërsi të Pejës, në tetor të vitit 2003, derisa ishin duke shkuar në punë.
Pra, sipas kësaj, disa ngjarje që ndodhën duhet shikuar edhe Brenda SHPK-ës. Nga kjo del se edhe vrasja e parë, por edhe e dyta janë bërë për të humbur gjurmë.
Se çfarë gjurmësh, se kush fshihet pas humbjes së gjurmëve dhe pas urdhrit për ekzekutimin e këtyre njerëzve, mbetet të shihet ndoshta me kalimin e kohës...
Klanet dhe kupolat e mafias së organizuar dihet se për t'i realizuar qëllimet e veta, nuk i kursejnë njerëzit e asnjërës palë.
Duhet përmendur që një grup me përmasa të tjera ishte edhe "Klani i Musajva", i cili, siç është parë, gëzonte edhe përkrahje edhe mbështetje të fortë politike. Ky klan mbrenda katër a pesë vitesh u shkatërrua, duke u vrarë në rrethana të pasqaruara disa nga vëllezerit Musaj, të cilët dikur gëzonin mbrojtjen e fortë nga partia më e madhe, LDK-ja pra e cila kishte vënë në shërbim të këtij klani edhe një pjesë të shtypit, që e mbulonte propagabdën dhe AGJITACIONIN KUNDËR strukturave të caktuara. Propaganda dhe mbështetja politike, por edhe mbrojtja ndërkombëtare që iu bë një kohë kësaj familjeje, ata i trimëroi aq shumë dhe i shtyri në gabime të pafalshme, duke bërë vrasje e krime mbi njerëz krejtësisht të pafajshëm (për këtë kemi shkruar më herët në forum). Thjesht, nga partia të cilës i shërbyen me besnikëri, duke përfshirë këtu edhe klane të caktuara partiake, këta njerëz i përdorën siç thotë populli, "mish për top".

SI I PËRDORNIN GAZETARËT PËR ARRITJEN E QËLLIMIT TË TYRE

Një fat të tillë e pësuan edhe disa gazetarë të cilët ishin të cytur dhe trimëruar për të shkruar dhe krijuar afera të rrejshme kundër ish-pjesëtarëve dhe liderëve të UÇK-ës dhe njerëzve tjerë me influencë në politikën kombëtare dhe ndërkombëtare.
Fatkeqësisht, pasi "shefat" (porositësit) e aferave ia arrinin qëllimeve të veta, gazetarët që i përdornin si vegla për arritjen e këtyre qëllimeve vriteshin për t'i humbur gjurmët. Një fat të tillë e pësuan edhe Bekim Kastrati bashkë me Besim Dajakun, Bardhyl Ajeti, Enver Maloku, Xhemajl Mustafa etj. Këto vrasje që i përmenda më lartë ndodhnin në prag të ndonjë procesi a ngjarje politike, apo për të bërë ndonjë aferë të caktuar. Këto vrasje, shefave, u shërbenin edhe për një gjë tjetër, për ta paraqitur vetën "viktimë" para faktorit ndërkombëtar, me qëllim të fitimit të një simpatie, por njëkohësisht edhe të një privilegji, që fatkeqësisht në saje të kësaj mjeshtërie të hollë arritën ta fitojnë me kalimin e kohës...

Kujt i shkonte për shtati mos ndriçimi i krimeve

Kjo d.mth, se mosndriqimi i krimeve dhe lënia e lirë e kriminelëve, u shkon për shtati më së shumti atyre që i kanë sponzorizuar krimet dhe kriminelët. Pavarësisht përqendrimit të madh të forcave të KFOR-it, Policisë së UNMIKU-t dhe SHPK-ës, pranisë së shërbimeve intelegjente, pastaj kontigjentit të hetuesve, prokurorëve ndërkombëtarë e vendorë, bëri që të dështohet në këtë drejtim, duke dështuar totalisht në zbardhjen e veprave kriminale dhe vënien e fajtorëve para drejtësisë.
Kjo është një mungesë vullneti për t'u përballur me strukturat e krimit të organizuar, është një mungesë e vendimeve politike, për të ndërrmarrë masa ndaj këtyre strukturave. Kjo bëri që të humbet besimi i qytetarëve në drejtësi, gjykata dhe deri diku në SHPK, polici të UNMIKU-t dhe më pas në KFOR.
E kujt është autorësia e akteve kriminale, dhe kush po tenton me çdo kusht ta destabilizojë Kosovën?!
"Dosjet" përgatiten në Serbi - gjykimet e dënimet i bën UNMIK-u në Kosovë. "Diktatet" vijnë nga ata që kanë bërë krime në Kosovë, e që sot kanë funksione të rëndësishme shtetërore e Partiake në Serbinë fqinje. Karakteri çlirimtar i luftës që zhvilloi populli i Kosovës në krye me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, u tentua vazhdimisht të zbehet dhe të tjetërsohet nga emisarët e UNMIK-ut.

Vrasjet e dëshmitarëve për humbje të gjurmëve
S'do mend që drejtësia dhe zbardhja e krimit u heshtë nga drejtësia ndërkombëtare dhe vendore, sepse siç duket strukturat e krimit të organizuar kishin lidhje të ngushta me rangje të larta në shtet dhe shteti domosdo nuk mund ta luftojë vetveten.
Si pasojë e saj u likuiduan edhe shumica e dëshmitarëve të proceseve gjyqësore, nëpërmjet të cilave kishin arritur t'i organizonin proceset për të mbetur anonimë /enigmë fytyrat e kreatorëve të këtyre proceseve. Me vrasjen e këtyre dëshmitarëve në njërën anë e mbulonin vetveten dhe nuk i përmbushnin premtimet ndaj tyre, kurse në anën tjetër ua rëndonin barrën edhe më shumë dhe i akuzonin përsëri të akuzuarit apo të dënuarit në ato procese të montuara, tani edhe për vrasjen e dëshmitarëve (!).
Seri vrasjesh të pazbuluara
VRASJET SERIKE TË ISH-USHTARËVE TË UÇK-ës
Mafia proserbe, duke pasur edhe përkrahjen e disa qarqeve në Kosovë, kombëtare dhe ndërkombëtare ka qëndruar edhe pas vrasjes së Avni (Smajl) Elezajt (1981) nga Alba (ish Jablanica e vogël e Pejës).
Lidhur me këto vrasje, në një prononcim të KMLDNJ-së, ndër të tjera thuhej: "Vrasjet janë aq mizore sa që nuk mund të merren me mendë sa kanë ngjyrime politike. Këto janë më parë krime ordinere ose të shtytura me forcat e errëta kriminale, të cilat me krime të tilla synojnë vetëm destabilizimin e gjendjës në Kosovë, por edhe anarkinë dhe kaosin me pretendime të qarta, që të komprometohet organizata ndërkombëtare si e "paaftë për të qeverisur dhe mbajtur rendin e qetësinë në territoret nën administrimin e saj dhe për t'i kthyer forcat ushtarako - policore serbe " për të vendosur sigurinë në Kosovë"!
Shihet se dora vrastare e Serbisë po vepron papengueshëm në brendi të Kosovës. UNMIK-u tregohet indiferent ndaj sigurisë së vendit. Vrasja e Avni Elezajt hyn në vazhdën e sulmeve kundër ish- pjestarëve të UÇK-ës dhe TMK-ës. Ai u vra më 12 tetor 2002, në afërsi të Restoranit "Peja City", bashkë me Bekim Mustafën (1975) nga Klina e Poshtme e Skënderajt me banim në Arbëresh (ish-Vitomiricë) të Pejës, të dy pjestarë të UÇK-ës. Madje

në Avniun njëri nga ekzekutuesit kishte qëlluar edhe nga afërsia, kur e kishte afruar makinën për ta verifikuar vdekjen e Avniut.
Për atë se si është përgatitur likuidimi i Avni Elezajt - pak më vonë - ndërsa tashti do të shkruaj edhe për disa raste të pandriquara, e ku viktima ishin ushtarët e UÇK-ës.
Nuk është zbardhur AS VRASJA e Sadri Berishës - komandant "Sykit" të UÇK-ës nga Grabanica e Klinës. Kjo vrasje ndodhi 10 ditë pas vrasjes së komandantit të batalonit të Dytë të TMK-ës, Skënder Gashit, i cili në rethana krejtësisht të panjohura për opinionin e gjerë ishte masakruar, më 20 shtator 2000, në Sapniq të Rahovecit. Tre muaj më herët, ishte bërë edhe vrasja e Metë Morinës nga Grabanica, po ashtu ish luftëtar i UÇK-ës. Po në Grabanicë të Klinës më vonë u vra edhe Shaqir Krasniqi, ish - pjesëtar i UÇK-ës dhe epror i lartë i TMK-ës.
Para se të vritej, Shaqiri ishte kërcënuar nga njerëzit e një krahu të njohur politik, e pastaj ishte vrarë në një pritë të organizuar tek "Ura e Bistricës", i cili ishte duke u kthyer nga vizita, që ia kishte bërë, një të afërmi në fshatin Dollovë, bashkë me nënën e tij, e cila ishte plagosur, kur vrasësit kishin shtënë, mbi djalin e saj. Policia ka qenë, në dijeni, se kush e ka kërcënuar dhe nuk ka marrë masa.
Sipas policisë, kërcënuesi ka qenë arrëstuar dhe më pas i liruar. Në Grabanicë, siç u tha edhe më lartë, kishin ndodhur një vargë vrasjesh të fshehta; si vrasja e Metë Morinës, Sadri Berishës, Metë Jahës, Burim Sejdiut, i cili ishte djali i vetëm, pastaj Sabit Rexhepit, i vrarë në oborrin e shtëpisë së tij, në fshatin Zabërgjë dhe së fundi, e Shaqir Krasniqit. Të gjitha, në fakt, vrasje të pazbuluara...
Bastisja e Avni Elezajt para se të vritej
Duhet theksuar se disa ditë para se të vritet Avniu, ai disa herë bastiset dhe kërcënohet nga pjesëtarët e SHPK-së, disa herë edhe e kanë çarmatosur. Ndoshta, kjo nuk është e rastësishme sikur që nuk ishte e rastësishme as thirrja e "presidentit" Rugova që "në ShPK-ë duhet të punësohen ish-policët e Kosovës. Avniu pas luftës një kohë ishte pjesëtar i TMK-së e më vonë pjestarë i mbrojtjes së afërt të liderit të AAK-së, Ramush Haradinajt. Më herët ndaj tij kishte pas disa tentim vrasje të tjera. Madje njëra prej tyre, e kryer në Albë të vogël, deri sa po kthehej në shtëpi me veturë, ishte më seriozja. Më se 30 plumba kishin depërtuar tejpërtej makinës, por fatmirësisht kishte shpëtuar. Kjo kishte ndodhur në të njëjtën ditë,

kur vetëm disa orë më parë, disa pjestarë të SHPK-së kishin tentuar t'ia merrnin armën me leje që e posedonte, gjë që e bënë pas këtij tentim - vrasjeje. Pra kur s'munden ta vrasin nga prita disa ditë më vonë i morën armën që e kishte me leje.
Ngjarjet rreth Avniut në korrelacion me SHPK-në disi marrin një ndërlidhshmëri të pakuptimtë. Edhe pse vendi i krimit nuk ishte largë nga Stacioni i policisë, kjo e fundit del me vonesë në vendin e krimit, dhe si zakonisht edhe këtë radhë vrasësit "mbesin të panjohur".
Edhe pse pothuajse të gjithë e dinë se kush e vrau Avnin dhe Bekimin, kush urdhëroi vrasjen e tyre dhe kush ishin kryesit, vrasja mbetet enigmë. Pasi që Policia e UNMIK-ut dhe SHPK-ja nuk kishin bërë asgjë për zbardhjen e rastit, këtij problemi i mbetet t'i hyjë privatisht babai i Avniut, Smajli, i cili pasi arrin ta lokalizoj vrasjen dhe vrasësit, më 17 mars 2004, vetëm pak orë para shpërthimit të protestave të marsit në Pejë, afër vendit të punës, vritet SMAJL ELEZAJ, babai i Avniut, mbase pse u kishte rënë në gjurmë vrasësve të të birit.
As kjo vrasje nuk u ndriçua edhe pse u bë në pikë të ditës.
***
Vrasje tjetër e ish-ushtarëve të UÇK-së ishte ajo e Agim Makollit në Matiçan të Prishtinës por pasi që kjo vrasje lidhet me Fadil Suleviqin (dëshmitarin në procesin gjyqësor në mes Bukoshit dhe Adem Salihajt do ta lëmë këtë për më vonë, kur do të flasim, për vrasjet e disa veprimtarëve të LDK-së)..

Vrasja e Besim Malës - komandant Murrizit

Vrasje të ish-Ushtarëve të UÇK-së, të projektuar mirë nga qarqe të vendosjes nga ishin bërë edhe Dosjet për të dërguar disa çlirimtarë në gjykatën e Hagës, aty ku ishin bërë edhe më herët, siç ishte rasti me Besim Malën (Komandant "Murrizi") i cili paraprakisht ishte çarmatosur nga UNMIK-u, e pastaj u vra.
Vetëm disa ditë para se të vritej në atentat, UNMIK-u, pa kurfarë shkasi apo arsyetimi, ia kishte marrë lejen e armëmbajtjes dhe armën me leje që e posedonte. Pa ndonjë hezitim mundë të thuhet që në vrasjen e Komandant "Murrizit" kanë marrë pjesë dhe kanë dorë shërbimet sekrete serbe, i përfshirë në të edhe ndonjë përkrahës në radhët e UNMIK-ut, në bashkëpunim me mafian e

Organizuar e cila përplasej atë botë për të dominuar në nëntokën kosovare
Tashti, kur të kemi parasysh që nga ana e serbëve është potencuar shumë herë se në Kosovë kanë 25 000 deri 50 000 bashkëpunëtorë. Ky klan kishte shtrirje dhe ka operuar në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe më pak në disa Rajone të Shqipërisë, me ç'rast pas vrasjes së Gjingjiqit, pjestarët e këtij klani mafioz, morën goditje edhe në Kosovë. Po të shikohet në retrospektivë, do të shihet që ai klanë kishte përkrahjen e disa segmenteve të caktuara të UNMIK-ut në raste dhe vende të caktuara.
Pastaj nuk supozohet kot që ish komandanti Valerij COROTECNO, ka qenë njëri ndër koordinatorët dhe mbështetësit e kësaj mafie. Në këtë kohë ish lideri i Partisë më të madhe të Kosovës qëndronte akoma në Itali..
Në mesditën e 16 prillit të vitit 2000, në qendër të Prishtinës përballë ndërtesës së Radio Kosovës, u vra Besim Mala, i njohur me emrin e luftës komandant "Murrizi", komandant i Batalionit për ndërhyrje të shpejtë në kuadër të Gardës së Trupave Mbrojtëse të Kosovës, i cili dha kontribut të jashtëzakonshëm në forcimin e Gardës së Kosovës. Ndërkaq, gjatë luftës Besim Mala e kishte kryer detyrën e oficerit të lartë me Njësinë Speciale të Zonës Operative të Drenicës, i cili për trimërinë e treguar gjatë luftës, për pjesëmarrjen aktive në shumë aksione e beteja të përgjakshme gjatë Luftës Çlirimtare, ishte bërë i njohur jo vetëm në rajonin e Drenicës, por në mbarë Kosovën.
Ai u vra gjatë orarit të punës, me uniformë të TMK-së.
Me këtë rastë, Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së, krahas dënimit verbal të kësaj vrasjeje makabre të njërit ndër pjestarëve më të dalluar të UÇK-së dhe TMK-së, nëpërmjet një kumtese kërkoi nga organet kompetente që sa më shpejtë të SQAROHET RASTI, TË GJENDEN VRASËSIT DHE TË NXIRREN PARA GJYQIT, TË BËHEN MË SHUMË NË PARANDALIMIN E KRIMIT DHE SHUARJEN E BURIMIT TË TIJ. EDHE KJO VRASJE BËN PJESË NË SERINË E VRASJEVE TË NJËPASNJËSHME, ku viktima ishin pjestarët e ish - UÇK-së.
ANDAJ nuk është e çuditshme që "shefat" i dërgonin e- mail njëri tjetrit dhe njerëzve të tyre në "stilin se, e shifni se çfarë mjegullnaje kemi bërë"... Për çudi, në shumicën e rasteve ka

ndodhur që; në vendë që policia të marrë në pyetje dorasit, kriminelët, ka ndodhur e kundërta, si bie fjala, hetimi i një polici të SHPK-së... Pastaj, është shumë e çuditshme, se si ka qenë e mundur, deri sa në njërën anë çarmatoseshin ish - Ushtarët e UÇK-së, dhe të cilëve iu mirrreshin ato armë, të cilat edhe ashtu me leje i kishin, teksa nga ana tjeter, ca personave, të cilët kishin një të kaluar të turbullt bashkëpunimi, me ish-regjimin serbë, në dëm të popullsisë shqiptare, u lejohej armëmbajtja??!!
Por në raste të shumta, edhe pajiseshin me to, me armë pra, nga vet Organet e SHPK-së e sidomos të UNMIK-ut...
***
Këto vrasje dhe të tjerat si këto, janë bërë nga armiqtë e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, të cilët e kanë pasë të vështirë ta pranonin fitoren e UÇK-së mbi forcat armike, të cilët mendonin se me vrasjen e çlirimtarëve mund ta kthenin regjimin serb përsëri.
Por ata dhe këta gabojnë ngaqë përfundimisht, e kanë humbur luftën dhe përpjekjet, për kundërvënie mbi forcat e UÇK-së të cilat ishin dhe do të jenë të kota. Ato të kota do të jenë edhe në të ardhmen megjithëse, katër vite pas lufte, ani pse kishim SHPK-ën dhe TMK-ën, me uniforma të pranuara, në varrimin e Tahir Zemës, publikisht kishte dalur ushtria e re paramilitare, me simbole dhe Uniforma të veta, konform ligjeve në fuqi, ku në çdo vendë të botës, këta pjestarë do të arrestoheshin ose së paku, do të mirreshin në pyetje, nga pushteti… Por në Kosovë kjo gjë nuk ndodhë ngaqë këta ishin pikërisht njerëzit të cilët u kujdesën që pushteti sërish të jetë në duartë e atij që priste në Itali që të ndodhnin ngjarjet.
Edhe vrasja e Avni Hajdarajt, ish - pjestarë i UÇK-së në zonën e Shalës, vëlla i vetëm i nëntë motrave, në shkurtin e vitit 2000 nuk ishte rastësi.
Nuk janë rastësi as përpjekjet për ta ndarë TMK-në dhe dëshmorët e kombit, për interesa dhe përfitime partiake.
Më 27 janar 2001, në një lokal të Gjakovës, në rrethana enigmatike u vra edhe Mahir Lajçi (1981) komandant "Rugova" nga Peja, njëri ndër luftëtarët më të dalluar të UÇK-së dhe epror i njësisë së Mbrojtjes së afërt të TMK-së si dhe u plagosën dy të tjerë po ashtu luftëtarë të dalluar të UÇKsë…

Kjo vrasje u bë nga njerëzit e klanit mafioz të Partisë më të Madhe në Kosovë, LDK-së pra, madje vrasësit iu dha edhe njëfarë imuniteti, sepse kishte shtënë në ish-struktura të UÇK-së. Zakonisht në rastet kur zbuloheshin vrasësit, thuhej se vrasësit këto vrasje i bënin në "vetëmbrotje". Së paku gjyqtarët dhe drejtësia e Kosovës kështu i kanalizonte dhe i klasifikonte. Njerëzit që i vrisnin pjestarët e UÇK-së disi ishin të privilegjuar dhe të mbrojtur.

Atyre u jepnin edhe revole dhe armë tjera me leje për t'u "vetëmbrojtur" siç është rasti i Muriqëve, Musajve dhe të tjerëve. Pra deri në këtë shkallë kishte arritur urrejtja ndaj palës tjetër.

Madje kishte ndodhur që në gjyqet tona të dënohen me nga dy vite e gjysmë dy ish - pjestarë të UÇK-së dhe të TMK-së, vetëm se paskan shikuar me përbuzje një pjestarë të "hierarkisë së priviligjuar" dhe kinse të rrezikuar nga njerëzit e UÇK-së.

Atentatorët - pjesëtarë të strukturave kriminale serbe

Terrori i porositur ndaj strukturave të UÇK-së nuk ka të sosur. Kjo bëhej në mënyrë sistematike dhe shumë mirë të planifikuar. Pre e këtij terrori bie edhe Ramiz M. Kiçina, pjestarë i Gardës së Kosovës në TMK dhe vëlla i dy dëshmorëve të UÇK-së, i cili, pasi ishte sulmuar në Qendër të Drenasit, vdes nga plagët e marra.

Një fat të tillë tragjik do ta ketë edhe luftëtari i UÇK-së Nezir Dilaveri (33) nga Shtupelli i Klinës, i cili u vra më 13 nëntor të vitit 2000.

Më 21 nëntor të vitit 2000, në Gjakovë pa asnjë arsye, vritet Frashër (Imer) Syla (21) nga Hereçi i Gjakovës, ish - luftëtar i dalluar i UÇK-së.

Frashër Syla u vra nga persona të afërt me të ashtuqujturën "polici lokale" (nëse ju kujtohen qenë formuar në bazë të marrëveshjes Rugova - Millosheviq) të Serbisë.

Injorimi i Luftës dhe i pjestarëve të UÇK-së e të TMK-së, po cytet nga e njejta shtresë njerëzish, të cilët e injoruan Luftën, që në fillim dhe ishin kundër saj gjatë gjithë kohës, një pjesë e të cilëve iu bashkua njësive paramilitare dhe militare të forcave serbe, të cilët luftuan me të gjitha mjetet kundër popullit të vet. Janë ata që vepruan përkrah forcave ushtarako - policore dhe paramilitare në masakrën e Mejës dhe në masakrat e tjera anëkënd Kosovës.

Janë ata që organizuan me dhjetëra prita kundër pjestarëve të UÇK-së gjatë luftës, në të cilën u vranë qindra ushtarë, me qëllim të shuarjes së luftës çlirimtare.
Janë njerëzit e Arkanit dhe Sheshelit të cilët i ndihmuan politikisht, ushtarakisht dhe financarisht.
Kujtoni deklaratën e tre paguesve me paga nga Shqipëria, të cilët janë në vuajtje të dënimit e që kishin deklaruar që kanë marrë një shumë prej 350 000 markave Gjermane...
Janë njerëzit e besueshëm të shërbimeve të mëhershme serbe, pra të besueshmit e UDB-së dhe të KOS-it.
Janë njerëzit e shërbimeve sekrete serbe që po tentojnë ta kthejnë Serbinë në Kosovë. Këta janë ata që po tentojnë të sfidojnë ish - luftëtarët e UÇK-së dhe luftën e shenjtë që e bënë për liri e çlirim, dhe strukturën e TMK-së, si institucion më i rëndësishëm i shtetit...
Nga strukturat e bandave të përmendura vritet edhe Xhemajl Buçolli, pjestarë i një familjeje të njohuar nga fshati Raushiq i Pejës, i cili ishte njëri që nuk ishte përzier kurrë në punë të dikujt tjetër. Në kohën e luftës radhitet në radhët e UÇK-së.
Ai pas luftës i kthehet punës. Me djersë e mund, duke punuar pandërprerë e fitonte kafshatën e gojës. Xhemajli u vra nga strukturat e mafias së organizuar të nëntokës së Pejës me rrethinë, në bashkëpunim edhe me grupet mafioze që i sillnin nga Shqipëria si vrasës me pagesë me qëllim plaçkitjeje.
Më 10 korrik 2000, në pikë të ditës Besnik (Elez) Balaj nga Isniqi, në tavernën e lokalit hotelier "Deçani" vrau publikisht me armë automatike bashkëvendasin e vet Sadri Ahmetxhekajn, luftëtar i UÇK-së. Dëshmitarët tregojnë se pas vrasjes makabre, besniku bërtiste "e nxora gjakun e vëllait, e nxora gjakun e vëllait..."
Lidhur me vrasjen e Sadri Ahmetgjekajt, të nesërmen më 11.7.2000, zëdhënësi i Komandës Italiane të KFOR-it në Pejë, koloneli XH.S. i tha agjencisë ANSA se fill pas vrasjes është ndaluar shqiptari Besnik Balaj, i cili u dorëzua menjëherë policisë së Kombëve të Bashkuara. ("KOSOVA SOT" e datës 12.07.2000).
Por deklarimin e bërë një ditë pas vrasjes, zëdhënësi i KFOR-it e mohoi të nesërmen, duke thënë se nuk është zënë vrasësi, por është marrë në pyetje një anëtar tjetër i familjes Bala.

Në rastin konkret përflitet se një deklarim i tillë është bërë me qëllim që Besnik Balaj, pas vrasjes makabre të kalonte në Shqipëri pa asnjë pengesë.
Babai i vrasësit Besnik Balaj, gjatë luftës kishte punuar haptazi me policinë serbe. Ai kishte bërë dorëzimin (njësoj sikurse një forumist që ka pohuar këtu që ka bë të njejtën gjë) e armëve te policia në Isniq dhe ishte caktuar kryepolic lokal i Serbisë, për bashkësinë Lokale të Isniqit, duke poseduar librezë përkatëse, revole, por edhe pushkë automatike që ia kishte dhënë policia serbe për të Luftuar kundër UÇK-së..
Sulm i drejtuar edhe kundrejt foshnjave
Nga të njejtat struktura të Lidhura me "Klanin e zemunit" - viktimë i së cilës mundet me qenë edhe Tahir Zemaj (apo luftë me Marajn për pozicionin e njishit), do të goditet rëndë Idriz Balaj nga Gllareva e Klinës, emër i njohur në UÇK, si komandant i Njësisë "Shqiponjat e Zeza" në ZOD, i cili me punën dhe angazhimin e tij ishte dalluar edhe në TMK, një kohë edhe si zv/ komandant i batalionit Gardist në Zonën e Tretë të Mbrojtjes.
Në mbrëmje të 20 janarit të vitit 2002, Idrizit i kishin montuar eksploziv para derës së hyrjes në shtëpinë e tij në Gjakovë, përderisa bashkë me gruan dhe djalin gjendeshin te një mik i tyre në qytet. Kur kthehen sapo i afrohen derës së hyrjes, aktivizohet eksplozivi dhe nga shpërthimi i fuqishëm plagoset rëndë Idriz Balaj, e shoqja e tij T.... po ashtu pjestare e TMK-së, e cila aborton foshnjën dy muajshe, humbë njërën këmbë dhe merr plagë të rënda në gjithë trupin (shpëton vetëm në saje të ndërhyrjes së mjekëve në Bondstill), ndërsa djali i tyre S... (16 muajsh) pëson tronditje të brendshme.
Ishte ky njeri ndër sulmet më makabre të kryera ndaj pjesëtarëve të TMK-së në Kosovën e Lirë, sulm i drejtuar edhe kundrejt foshnjave.
Vlen të përmendet se kapotë e krimit të organizuar në disa raste atentatet i kishin përgatitur nëpërmjet eksplozivit me telekomandë, njësoj sikurse që janë përgatitur nga të njëjtat struktura bombat e fundit të krisura në Komunën e Gjilanit.
Shumica e rasteve në fjalë nuk janë zbuluar as sot e kësaj dite, siç është edhe rasti i Idriz Balajt dhe njerëzve të tjerë..

Si u vra Avdi Mujaj - "Trimi" veprimtar i njohur i çështjes Kombëtare?

Shërbimet sekrete serbe nëpërmjet bashkëpunëtorëve të vet në Kosovë, organizuan vrasjen e djemëve dhe luftëtarëve më të spikatur të UÇK-së. Një fat të tillë e pësoi edhe Avdi Mujaj nga Strellci i Deçanit. Kjo vrasje ishte edhe një dëshmi tjetër që tregon se Kosova ishte e pambrojtur nga Serbia.

Avdi Mujaj, i njohur me nofkën e Luftës "Trimi", ishte anëtar i Këshillit të Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK-së) në Arau të Zvicrës që nga vitit 1986, gjithnjë në detyrat më të vështira dhe në kohërat më të vështira. Në organizimin e qindra demonstratave, tubimeve e në veprimtari të ndryshme për Kosovën. Kontribut të jashtëzakonshëm dha edhe në në mbarëvajtjen e punës në "Zërin e Kosovës", në shoqërinë kulturore "Luftëtarët e Lirisë", në Fondin e Luftës "Vendlindja Thërret", në sektorin për çështje praktike të kryesisë së LPK-së etj., duke u dalluar gjithnjë për punën e palodhshme dhe përkushtuese për liri e çlirim.

Ai bëri gjithçka për rritjen dhe forcimin e UÇK-së. Dhe përseri iu duk pak. Rroku armët dhe hyri në Kosovë atëherë kur shumëkush largohej nga Kosova, dhe luftoi e qëndroi heroikisht deri në fund. Ishte ai djaloshi me automatik në duar, që me disa të tjerë, në qoshe të një muri të lagjes, ishte filmuar nga largë nga një kamerman i EURO NJUSIT kështu që ajo pamje kish marrë dhenë; se në Kosovë ka luftëtarë dhe se aty mbrohet Kosova dhe Luftohet për lirinë e saj. Ishte maji i vitit 1998...

Vrasja e Avdi Selim Mujës nga Strellci, para derës së shtëpisë dhe para syve të familjes dhe fëmijëve si dhe plagosja e tre kusherinjëve të tij, vëllezërve V... (të njohur per ne.. i plagosur rëndë), F... dhe F....Mujaj, është vrasje e kryer në orët e vona të natës së 1 tetorit të vitit 2003, në oborrin e shtëpisë së Avdiut. Edhe kjo vrasje makabre, deri tani ka mbetur "enigmatike" me vrasës të "panjohur".

Avdi Mujaj është sulmuar edhe njëherë tjetër në fund të korrikut të vitit 1999, kur persona të panjohur i kishin ngritur pusi nga mali në rrugën Baran - Pejë. Dhjetëra plumbi kishin depërtuar në veturën e tij derisa po udhëtonte në drejtim të Pejës, por kishte mbijetuar... Përpjekje për vrasjen e tij kishte pasur edhe në Zvicër...

Një krim i ngjashëm kishte ndodhur edhe në Dushkajë të Gjakovës. Këtij krimi i dha mjaftë hapësirë edhe shtypi beogradas. Shtypi në fjalë disi e jep një sihariq për likuidimin e "terroristit" Sadik Zeneli.
Si në rastin e vrasjes së Avdi Mujajt, si në atë të Sadik Zenelit, si në rastin e vrasjes së MUSA HOTIT në Belgjikë (ndihmësi i atentatorëve shqiptarë i njohur), caku ishte i njejtë: goditja e atdhetarëve (veteranë) që nga disa dekada të jetës së tyre ua kishin kushtuar përpjekjeve për lirinë e KOSOVËS.

VRASJET E DISA VEPRIMTARËVE TË LDK-së

Gjatë këtyre periudhave ndodhën edhe disa vrasje serike mbi veprimtarët e dalluar të LDK-së siç ishte vrasja e Haki Ymerit, ish - anëtar i degës së LDK-së në Skënderaj, e Shaban Manajt, anëtar i Kryesisë së KP të LDK-së në Istog, e kryetarit të Komunës së Kleinës Ismet Rracit, pastaj vrasja e deputetit të Parlamentit të Kosovës, Smajl Hajdarajt, Xhemajl Mustafës, këshilltar për informim i presidentit Rugova e deputetit të LDK-së, vrasje e Kosovë Zeqirajt dhe Albert Zeqirajt përkrahës të LDK-së në Istog...
Këto vrasje dhe një varg vrasjesh tjera të kësaj natyre, duke pasur edhe motive të përafërta me to, janë vrasje serike të përsëritura, vrasje me porosi nga një dorë vrastare, prapa të cilës qëndron hija mbështetëse e segmenteve të forcës, ligjit dhe politikës.
Është shumë interesante të thuhet që të gjitha këto ekzekutime janë bërë në mënyrë identike; pra në hyrje të banesave të viktimave. Kur jemi te Xhemajl Mustafa kësaj radhe nuk do të flasim për këtë gjë ngaqë më herët veç kemi shkruar sikurse që dihet që; ai është ekzekutuar nga personat e njejtë, të cilët kanë kryer urdhërat e "shefave", të cilët kanë qenë ngushtë të lidhur me "Klanin e Zemunit" dhe me disa nga njerëzit kyq të Partisë më të madhe në Kosovë...
Mendimi im është që këta të gjithë janë të viktimizuar nga vet partia e tyre Lidhja Demokratike e Kosovës. Gërshetimi i këtyre interesave ka bërë që gjerë më tani këto vrasje të mbeten "të pa zbuluara" pra vrasje të ditura por "të pa ndriqura".

VRASJA E DEPUTETIT SMAJL HAJDARAJ

Shumë herë është bërë pyetja: "kush e vrau deputetin Smajl Hajdaraj?", duke aluduar dhe bërë me gishtë nga njëra palë, sipas porosive të "padronëve" me qëllim njollosje të një kategorie të

njerëzve të caktuar. Deputeti i Parlamentit të Kosovës, Smajl Hajdaraj, para se të vritej, në faktë kishte pasur një varg kërcënimesh nga elementë revanshistë që nga viti 1998 duke e quajtur sabotator të UÇK-së, më pastaj duke e shantazhuar në punë sa ishte drejtor i Distribucionit të Elektro Kosovës në Pejë. Disa herë kishte pas konflikt të hapur me qarqe të ndryshme brenda LDK-së, për ç'gjë vetëm pak kohë para se të vritej, e kishte njoftuar detajisht me shkrim Kryetarin Rugova
Një problem të hapur e kishte PASUR ME ATË KLAN edhe gjatë luftës. Të tillët edhe pas luftës patën konflikt të hapur me Smajl Hajdarajn, madje nuk e lanë as t'i afrohej kryetarit Rugova në tubimin elektoral në Pejë gjatë fushatës së zgjedhjeve presedinciale.
Në një rast tjetër, z. Hajdaraj, ishte kërcënuar me vrasje nga disa pjesëtarë të këtyre strukturave, pasi nuk i kishte lënë të hyjnë mbrenda në Objektin e Komunës në Pejë, ditën kur u bë hapja e Zyrës Flamane në Pejë, ku ishte i pranishëm edhe kryetari Rugova. Ngjarja e fundit kishte ndodhur vetëm disa ditë para vrasjes së deputetit.
Deputeti Hajdaraj në një mbledhje të kryesisë së LDK-së dhe të deputetëve të LDK-së, kishte deklaruar se "nëse shkoni me "POVRATAKUN" unë do të dal publikisht kundër". Ai nuk vuante nga paragjykimet. Andaj vrasja e tij ishte një vrasje nëpërmjet së cilës mendohej të goditej unifikimi i faktorëve shqiptarë në diasporë por edhe në Kosovë. Realiteti objektiv që duhet të jetë është - fajtorët në burg.
Edhe Ali Lajçi aso kohe kishte deklaruar që: Ministresha e pushtetit lokal e që ishte në Pejë, pas një zënke dhe mospajtimi me Lajçin dhe atë gjithnjë, sipas Lajçit, Tërmkolli e ka kërcënuar atë, derisa po ulej në karrigen e mysafires. "Me mua nuk të shkon, se ta bëj si Smajl Hajdarajt", tregon Lajçi farë i ka thënë Tërmkolli.
Smajl Hajdaraj u vra më 17 janar 2002, ditën kur njëzet vjet më parë u vranë edhe Vëllezrit Gërvalla dhe Kadri zeka. U vra në hyrje të banesës së tij (njësoj sikurse Xhemail Mustafa, Ismet Rraci...) në "lagjen Fidanishtja" të Pejës, me pistoletë, nga dy persona, të cilët analistët i cilësuan si "vrasës me porosi".
Smajl Hajdaraj ishte aktivist i çështjes Kombëtare dhe njëri ndër organizatorët e UÇK-së në Rugovë. Ditën e varrimit para mijëra të

pranishmëve, zyrtarë të lartë të Kosovës, parlamentit dhe të partisë por edhe të UNMIK-ut lexuan telegrame dhe jetëshkrime mbi veprimtarinë e bujshme politike - ushtarake të deputetit Hajdaraj. Ata u zotuan se nuk do të shkon larg dita kur para drejtësisë do të gjenden ata që ngrehën gishtin e krimit dhe e bënë këtë vrasje mizore. Mirëpo, me sa u pa, që nga ajo kohë e gjer më sot premtimet mbetën boshe dhe dhimbja për Smajl Hajdarajn i mbeti Familjes dhe farefisit. Nga të gjithë folësit në këtë tubim mortor, vrasja e tij u cilësua vrasje me paramendim kurse për ndriçimin sa më të shpejtë të rastit ishte zotuar edhe policia e UNMIK-ut.

Vlerësimet paraprake të shtypit të verdhë

Pra, elementet të lidhura ngushtë me disa nga krerët e Partisë më të madhe dhe në bashkëveprim me "Klanin e Zemunit" kontrollonin edhe një pjesë të shtypit. Në vlerësimet e shtypit që mbështetnin vijën partiake, vrasja e Smajl Hajdarajt (ani pse ai veç pak ditë më parë me shkrim e kishte njohtuar presidentit Rugova për kërcënimet) u klasifikua si vrasje nga kriminelë të vijës së majtë politike" në Kosovë vijë kjo që realisht nuk ekzistonte por ishte paragjykuar nga propaganda e disa gazetarëve (pjesëtarë të klanit) të cilët i klasifikonin strukturat të ish-UÇK-së dhe luftëtarët tjerë të lirisë me sofizma të tilla si "marksistë - leninistë", "enveristë", "nanoistë", "stalinistë", "për "dhunën politike" etj... që kishte qëllimin e caktuar dhe domethënien e vet të madhe - hedhjen në tabor të armikut të të gjithë atyre që ishin përpjekur për çështjen kombëtare dhe lirinë e vendit, për t'i dhënë vetës hapësirë për tu veshur me petkun e patriotizmit.

Sofizma të tillë u ka ra të dëgjoni dhe të lexoni po ashtu edhe sot, me porosi dhe qëllim të caktuar, për të mjegulluar sa më shumë ngaqë "ujku gjuan më së miri kur ka mjegull"..

Paraqitjet e tilla në Kosovë dhe jashtë Kosove, (me direktiva nga "shefat" dhe nga "Klani i zemunit") Ishin edhe një kurth për ta ngjallur dhe thelluar LUFTËN VLLAVRASËSE NDËRMJET VETI, NË MËNYRË QË ELEMENTË TË CAKTUAR TË SHOQËRISË TË PËRFITOJNË NGA FATKEQËSITË E TË TJERËVE.

Fatkeqësisht, pas çdo akti, janë gjetur persona apo "gazetarë të pavarur" dhe të "varur" të cilët me qëllim apo pa të, me paragjykimet e tyre kanë mjegulluar gjendjen dhe kanë thelluar

hendekun e ndarjes mes forcave politike, gjë që gjithnjë u përcoll me rrezikun permanent të inicimit të përshkallzimit të situatës në shkallë më të gjerë...
***
Vrasja e deputetit Hajdari kishte ndodhur në prag të marrëveshjës paraprake ndërmjet udhëheqësve politikë të Kosovës për krijimin e institucioneve të Kosovës. Në këtë mes "dikush" sipas asaj që deklaron bashkëshortja e Smajlit-Kimetja, u kishte thënë dhe i kishin bindur familjarët e Smajl Hajdarajt që të mos e lejonin TMK-ën të marrë pjesë na varrimin e tij.
Ky hap, në bashkëveprim gjithnjë të klaneve që kishin edhe përkrahjen e disa nga udhëheqësit e Partisë më të madhe dhe sipas kërkesave të furnizuesve me mjete materiale, që e bënte "Klani i Zemunit" ia arritën që të hapin dhe të bëjnë një thellim hendeku ndërshqiptarë, sespe një strukturë njerëzish punonin për shuarjen e TMK-së, përkatësisht spastrimin e saj nga elementi UÇK-ë dhe shndërrimin në një strukturë tjetër pro serbe (si FARKU bie fjala).
Prandaj mos lejimi i pjesmarrjes së TMK-së në varrimin e deputetit Hajdaraj, bëri që familja e tij të bie pre e kurtheve të shtresave të caktuara, të cilat emrin e tij dhe të njerëzve tjerë të ndershëm e përdorën për t'u ngjitur shkallëve të karrierës. Mu ata gjithnjë në bashkëveprim me "Klanin e Zemunit" (e dihet që kriminelët nuk njohin as fe e as Atdhe) këtë vrasje do ta cilësojnë si "Vrasje politike" e kryer nga ana e ish - pjesëtarëve të UÇK-së ende pa u zbardhur motivet e vrasjes, qëllimi, as arsyeja.
Ata paragjykonin dhe mu këto paragjykime shkaktuan huti dhe ngatërrim ngjarjesh në opinionin e gjerë. Ata i lanë që sa kohë vrasjet të pazbuluara sepse ishte në dorën e tyre aq më parë që kishin deklaruar në shtypë se i dinë vrasësit.
E nëse i dinë se cilët janë shtrohet pyetja: se përse këtë gjë se kanë bërë deri më tani, pra denoncimin e tyre?
Përgjigja është e thjeshtë: ngaqë vrasësit gjendeshin në mesin e tyre!
Shumë nga vrasjet e aktivistëve të LDK-së u kanalizuan se janë organizuar nga "terrori i kuq" për rritjen e objektivave politike nëpërmjet dhunës. Në një mënyrë, kjo është shkalla e parë e njohjes apo e dezinformimit për ta mbuluar krimin, që në gjuhën e

shkencës quhet "ASANIM". Në një editorial të kohës në të përditshmën "BOTA SOT" (Gazetë që finacohej nga vet "Klani i Zemunit") shkruhej se vrasja e martirit të Kosovës dhe të kombit shqiptarë Smajl Hajdaraj është bërë me urdhrin e dhënë nga të njëjtit urdhërdhënës si dhe për vrasjet e tjera...
Kush po e saboton zbardhjen e vrasjeve?
Nga mafia politike proserbe dhe nga disa shkrues të shtypit të verdhë, urdhërdhënësit janë treguar me gisht, me emër dhe mbiemër, me adresë. Meqënëse kriminelet dihen me emër dhe mbiemër, atëherë faji është te gjyqësia, te policia që nuk i arreston kryesit e veprave. Dikush po e saboton zbardhjen e vrasjeve që janë kanalizuar si vrasje politike...
Edhe vrasja e njeriut të lidhur mishërisht me serbët Ahmet Krasniqit, nga qarqe të caktuara është munduar të shfrytëzohet që në mesin e shqiptarëve të nxitej vlla-vrasja aq më parë që dihet; që Ai - Ahmet Krasniqi ishte i rrethuar me njerëz të cilët më parë ishin direkt të lidhur me shërbimin sekret serbë.
Tashti familja Krasniqi s'ka nevojë të ndjejë veten keq ngaqë siç thotë populli "s'ka mal pa derr të egër", Ahmet Krasniqi ishte njëri nga ata që u kishte shërbyer serbëve me besnikëri. Formimi i një të ashtuqujture ushtri (FARKU) e kishte për qëllim një farë lloj ballancimi të forcave në mesin e shqiptarëve, diçka e ngjashme si ajo Ushtria e Fikret Abdiqit në Bosnjë...
Kështu që edhe pse sot e kësaj dite kërkohet të dihet se si dhe nga kush u vra ky njeri, kjo gjë heshtet.
Ahmet Krasniqin e vrau mafia SHQIPTARE e lidhur ngushtë me Klanin e Zemunit, të cilët operonin në disa pjesë të Shqipërisë, me qëllim dobësimi të UÇK-së. Aso kohe flitej që atij i janë dorëzuar, 25 milonë marka gjermane dhe pikërisht ngaqë ishte i rrethuar, me njerëz si Tahir Zemaj, kjo edhe është arsyeja e vrasjes së dhëndërrit serbë!
Fazli Berisha oficer i APJ-së në Gospiq së bashku me Ahmet Krasniqin dhe njëri nga ata që kishte qenë gjatë me të, pra edhe në Shqipëri, po të intervistohet mund të thotë diçka më shumë... Gjendet në Gjermani...

Ti kthehemi sërish Smajl Hajdarajt

Sidoqoftë deklaratat e familjes së SMAJL HAJDARAJT, gjegjësisht të shoqes së tij, Kumrijes, e cila në disa intervista ka deklaruar se e

ka parë vrasësin i cili ishte një njeri me kaçketë (njësoj si në dy vrasjet e tjera të Xhemail Mustafës, Ismet Rracit, Shefki Popovës...) se atë e ka pritur një person tjetër, më tutje, me të cilin janë bashkuar më largë; se ata kanë pasur makinë "ASKONA" me ngjyrë të kuqe (është interesante se të gjitha makinat kanë ngjyrë të kuqe... Edhe gjatë vrasjes së Enver Haradinajt u tha se makina kishte ngjyren e kuqe...); se familja e Smajlit por edhe vet Smajl Hajdaraj gjithmonë ju ka frikësuar hyrjes së banesës...
Shtrohet pyetja pse? Nga kush? Çfarë kishte shkruar Smajl Hajdaraj në atë letrën me të cilën iu kishte drejtuar kryetarit Rugova dhe treguar se cilët janë personat që po e kërcenojnë!
Ndërsa ekspertët e policisë kanë deklaruar se në vendin e ngjarjes kanë qenë dy lloj fishekësh. Kjo vërteton se kanë qenë dy persona. familja e deputetit Hajdaraj kanë cekur në opinion se kishin pasur edhe dy telefonata anonime para se të vritej Smajli.
Kurse vëllai i Smajlit, Ademi, në vargun e kërcënimeve dhe presioneve që ka pasur, kishte cekur një problem të Smajlit, në një Manifestim në Loxhë, ku sipas tij, dy pjestarë të "TMK-së" (grupit paramilitarë që më vonë kishin dalë me uniforma të kaltra në varrimin e Tahir Zemës) e paskan kërcënuar dhe pastaj kishin dalë të njofshëm me Smajlin dhe shi për këtë i kishin dhënë një Ftesë në "KULLAT e BARDHA", siç i quan ai, i vëllai i Smajlit - Ademi pra, ku deputeti Smajl Hajdaraj nuk kishte shkuar.
Njerëz të shumtë të strukturave të caktuara, u deklaruan nëpërmjet shtypit por edhe kafeneve, ndejave edhe tubimeve si i dinë vrasësit e Smajl Hajdarajt, por ata vrasjen e tij e përdornin për marketing politik (ngaqë vet e kishin vrarë) askush prej tyre nuk shkoj në polici për të dëshmuar.
Smajl Hajdaraj ishte njeri i ndershëm, ish - epror i UÇK-së, i biri i ARI REKUT të Rugovës, i dënuar për çështje politike me shumë vite burgim në burgun e Goli Otokut. Ishte deputet i LDK-së, i cili i takonte grupit që brenda partisë së tij cilësohej si "më nacionalist", i cili kurdoherë asistoi në aspektin pozitiv të bashkëqeverisjes së Kosovës. Duket se kjo politikë nuk u shkonte përshtati disa rrymave, gjë që po shihet edhe sot.
Pse asnjë vrasje nuk është ndriçuar deri në fund?!
Sepse zakonisht është penguar që të ndriçohet sapo rrugët hetimore çonin në dyert e atyre që përfitonin politikisht nga këto

vrasje, Disa sish bëhen sikur nuk dinë gjë. Por, dielli me shoshë nuk mbulohet, thotë një fjalë e urtë popullore. Ata që përpiqen të përfitojnë nga vrasjet dhe t'i kompromet ojnë kundërshtarët me ato vrasje, kudo në botë, zakonisht janë sponzorët e tyre, janë porositësit e tyre. Dikush (kushdo qoftë), po mendon se tërë jetën mund ta fshehë fytyrën e tij. Kjo po ndodhë edhe me disa politikanë, të cilët sado që po shtiren dhe fshihen prapa akuzave, e din TA SJELLIM NË KUJTESË! NË EMËR TË POPULLIT PËR LIRI. Ka shumë nga vrasjet që në Kosovë pas lufte nuk janë zbuluar... Por unë me këtë rastë do t'ju shkruaj për një vrasje që u bë në vitin 1984 e që i dha më vonë jehonë dhe krahë Luftës sonë për Liri dhe bashkim Kombëtar. Kjo është edhe një porosi për të gjithë ata që luajnë një lojë të dyfishtë...)

Dimri i vitit 1984.

Kosova vuante nën terrorin e UDB-së, policisë speciale e cila edhe në këtë dimër të egër e kishte vështirësuar frymëmarrjen e saj.

Në janar të vitit 1984, UDB-ja mori aksion të përgjithshëm për ndjekjen dhe arrestimin e shokëve tanë trima dhe të gjithë atyre që ishin të dyshimtë. Nëpër qytetet e Kosovës ndiqeshin ilegalët të cilët punonin edhe në ato kushte shumë të vështira së bashku edhe me shokët tjerë, për bashkimin e të gjitha forcave revolucionare të Kosovës, që më pastaj në situata konkrete të uftës për LIRI (atëherë shkruhej për REPUBLIKË - vërejtja ime Tarasi), populli të ketë në ballë grusht të bashkuar bijtë dhe bijat e tij.

BAJRAM BAHTIRI u lind më 3 mars të vitit 1961. Ai rridhte nga një familje patriotike! Gjatë demonstratave të vitit 1981 ishte mjaftë aktiv dhe në ballë të tyre së bashku me shokë. Ai si student i Fakulltetit Juridik në prishtinë, kontakton me shumë shokë. Ai duke milituar me ta, i udhëzon studion literaturën dhe kontakton me shokun Nuhi Berisha me të cilin zgjerojnë aktivitetin në grupe. Aktiviteti i Bajram Bahtirit bie në sy të spiunëve të UDB-së dhe nga ajo merret dhe burgoset. Gjatë vitit 1983 torturohet shumë por asnjë fjalë nuk munden t'ia nxjerrin nga goja për shokët me të cilët kishte punuar dhe punonte. UDB-ja kishte angazuar sikur edhe më parë tradhtarët, spiunët dhe veglat e veta për t'i futur hundët kudo, për t'i gjurmuar ata që militonin në girin e popullit ata që luftonin për lirinë e tij.

Ata rrethoheshin tinëz, në befasi, me forca të mëdha policore të armatosura gjerë në dhëmbë, të mbeshtetura edhe me autoblinda. Por me 8 shkurt Bajram Bahtiri - Besniku shkroi Historinë për të mbetur përgjithmonë në të...
Pasi kishin rënë shokët Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha, për të cilët Bajrami dëgjoi menjëherë dhe ashtu siç ndodhej shtrirë i dërrmuar fizikisht nga torturat që ia kishin bërë UDB-ja (e cila ishte detyruar ta lirojë ato ditë) filluan përsëri t'i bëjnë presione edhe më të mëdha duke e shantazhuar dhe maltretuar me provokacione nga veglat e armikut. Ato ditë iu burgos edhe vëllai Rrahman Bahtiri, si pjestarë i Organizatës "Fronti Nacionalçlirimtar".
Xhevdet Ramabaja, të cilin UDB-ja e kishte shëndërruar dhe kalitur në vegël të vetën, i shkoi në shtëpi Bajram Bahtirit. Ai, gjoja si shok i dikurshëm i idesë dhe i luftës për liri shkoi lirisht në familjen e Bajramit. Bajrami nuk kishte si të dinte se Xhevdeti ishte zhytur në tradhti, se ai ishte bërë vegël e tyre, e UDB-së pra, të cilën kësaj radhe e kishte kurdisur për ta shantazuar shokun e dikurshëm; për t'i propozuar që të punojnë së bashku kundër popullit. Bajram Bahtiri - BESNIKU ishte habitur shumë dhe nuk u besonte veshëve të vet se çfarë fjalë po dëgjonte, nuk mund t'u besonte syve të vetë se në ç'gjendje ishte katandisur " shoku" i tij!
Në një moment Bajrami del nga dhoma. Në ato çaste kur mbeti vetëm Xhevdeti fillon të flasë me "dikend" përmes TOKI - VOKIT, të cilin e kishte pas me vete. Papritmas në dhomë hynë e motra e Bajramit dhe "mikun" e sheh me Toki - voki" në dorë duke folur me "dikend" të cilin e bënte me dije se Bajramin do të duhej domosdo arrestuar.
Ajo del me rrëmbim nga dhoma dhe i tregon vëllaut se çfarë pa dhe dëgjoi. Çdo gjë ishte e qartë! Bajram Bahtiri përgatitet shpejtë e shpejtë merr revolen dhe hynë në dhomë te "shoku", si Fortuna. "Shoku" kishte nxjerrë nga xhepi librezën e agjentit të UDB-së për t'ia komunikuar edhe zyrtarisht arrestimin Bajramit. Mirëpo, ky tradhtarit, ia zbrazi plumbat në ballë duke i thënë: "Tradhtinë duhet vrarë se e helmatisë trupin tonë të shëndoshë! Në emër të Popullit." Libreza e agjentit bie në tavolinë. Bajram Bahtiri del nga shtëpia për t'u arratisur por hasë në rrethimin që i ishte përgatitur me kohë. Me heroizëm qëndron ballë për ballë me

njesitë speciale duke e goditur atë me zjarrë. Pas një përpjekje të rreptë, 300 metra largë shtëpisë së vet, Bajram Bahtiri vritet nga rafalet e automatikëve të policisë...
(Kjo storie është shkruar në vitin 1985 nga Çelik Kalliri)

_____

Burimi:
- Gazetat:Zëri i Kosovës,
- Bota Sot,
- InfoPress,
- Shënime Personale nga Ditari Personal.
***

P.S. Këtë shkrim të shkurtuar në masë të duhur e kisha botuar ca vite më parë me pseudonim ku shkruaja në një portal dhe tani më thotë mendja që mund të botohet sërish.

▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼

© Pashtriku.org, Mars 2016